

Program trajnimi dhe manual për procedurat para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian



Kingdom of the Netherlands



ЦЕНТАР ЗА ПРАВНИ
ИСТРАЖУВАЊА И АНАЛИЗИ
CENTER FOR LEGAL RESEARCH AND ANALYSIS



GRAĐANSKA
ALIJANSA
Civil Alliance - Alianca Qytetare

Titulli:

Program trajnimi dhe manual për procedurat para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Botuesi:

Center for Legal Research and Analysis (CLRA), North Macedonia

Civil Rights Defenders, Albania

Civil Rights Defenders, Serbia

Civic Alliance, Montenegro

Autor:

dr Aniel Pahladsingh,

gjyqtar dhe komisioner pranë Institutit Holandez për të Drejtat e Njeriut

Redaktimi dhe bashkëpunimi profesional:

Milena Josifovska, CLRA

Martina Zafirovska, CLRA

Klejda Ngjela, Civil Rights Defenders Albania

Dizajni grafik:

Relativ

Vendi dhe viti i botimit:

Shkup, 2026

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit “Forcimi i Bashkëpunimit Gjyqësor Rajonal në Ballkanin Perëndimor për Ndjekjen Efektive të Çështjeve para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian”, i mbështetur nga Mbretëria e Holandës. Autorët mbajnë përgjegjësi të plotë dhe ekskluzive për përmbajtjen e këtij publikimi. Përmbajtja e tij nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve apo pikëpamjeve zyrtare të Mbretërisë së Holandës.

Tabela e Lëndës

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE (ABSTRACT)	5
HYRJE	7
1. Moduli 1: Hyrje në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe burimet digjitale	7
1.1 Mbi Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian	7
2. Moduli 2: Procedura e vendimit paraprak	10
2.1 Qëllimi i procedurës së kërkesës për vendim paraprak	10
2.2 Regjimi gjuhësor	11
2.3 Tre fazat e procedurës	11
3. Moduli 3: Hartimi dhe paraqitja e kërkesës për vendim paraprak	23
3.1 Kërkesa për vendim paraprak	23
3.2 Si duhet të hartohet një kërkesë për vendim paraprak?	24
3.3 Cilat formalitete duhet të respektohen?	24
3.4 Përmbajtja e kërkesës për vendim paraprak	24
4. Moduli 4: Procedurat urgjente dhe masat e përkohshme	26
4.1 Masat e përkohshme në Gjykatën e Përgjithshme dhe në GJDBE	26
4.2 Procedurat urgjente: PPU dhe PPA	27
4.3 Ndryshimet lidhur me kërkesat për vendim paraprak para Gjykatës së Përgjithshme	29
DOKUMENTET E ANEKSIT	33

Lista e shkurtesave

ACER	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë
AFSJ	Area of Freedom, Security and Justice (Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë)
AG	Avokati i Përgjithshëm (Advocate General)
BE	Bashkimi Evropian
CELEX	Identifikuesi CELEX
CPVO	Zyra Komunitare për Varietetet Bimore
EASA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë Ajrore
EBA	Autoriteti Bankar Evropian
ECHA	Agjencia Evropiane e Kimikateve
ECLI	Identifikuesi Evropian i Jurisprudencës
EIOPA	Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale
ELI	Identifikuesi Evropian i Legjislacionit
ERA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat
ESMA	Autoriteti Evropian i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve
EUIPO	Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizatë joqeveritare
PPA	Procedura e Përsheptuar
PPU	Procedura Paraprake Urgjente
RSS	Sistem për marrjen e njoftimeve automatike
TBE	Traktati për Bashkimin Evropian
TFBE	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Përmbledhje (Abstract)

Edukimi i vazhdueshëm juridik i sistemit gjyqësor është thelbësor për forcimin e aftësive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të drejtësisë, duke nxitur një qasje më të avancuar profesionale dhe duke i pajisur ata me njohuritë e nevojshme mbi jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE), si dhe mbi zbatimin praktik të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në kuadrin juridik kombëtar.

I mbështetur nga Mbretëria e Holandës, projekti rajonal “Forcimi i Bashkëpunimit Gjyqësor Rajonal në Ballkanin Perëndimor për Ndjekjen Efektive të Çështjeve para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së” synon të forcojë kapacitetet e aktorëve të sistemit gjyqësor në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbi dhe Shqipëri për zbatimin efektiv të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe të Kartës së të Drejtave Themelore, në funksion të procesit të ardhshëm të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Objektivat kryesore të projektit janë (i) forcimi i bashkëpunimit rajonal, (ii) shkëmbimi i njohurive dhe praktikave mbi sfidat e përbashkëta që lidhen me Kartën dhe procedurat para GJDBE-së, (iii) rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për përdorimin e procedurave para GJDBE-së dhe për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore.

Ky kurs me karakter shumë praktik do t’u ofrojë pjesëmarrësve një kuptim të thelluar dhe të avancuar të procedurës së vendimit paraprak pranë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE). Njohja e praktikës dhe jurisprudencës së GJDBE-së është thelbësore për realizimin e një dialogu të suksesshëm ndërmjet gjykatës kombëtare dhe GJDBE-së.

Përmes analizës së rasteve konkrete dhe diskutimit të jurisprudencës, pjesëmarrësit do të njihen me procedurat dhe mekanizmat kryesorë që mund të aktivizohen përpara GJDBE-së.

Në Modulin 1 trajtohen temat e mëposhtme:

- a) Hyrje e përgjithshme mbi funksionimin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) dhe Gjykatës së Përgjithshme, duke përfshirë kompetencat e GJDBE-së;
- b) Prezantimi i platformave CURIA dhe EUR-Lex, si dhe mënyrat e kërkimit të informacionit mbi vendimet gjyqësore, opinionet, çështjet në shqyrtim pranë GJDBE-së dhe dokumente të tjera të rëndësishme për gjyqtarët kombëtarë, siç janë Rekomandimet drejtuar gjykatave kombëtare lidhur me fillimin e procedurës së kërkesës për vendim paraprak;
- c) Llojet e ndryshme të procedurave që zhvillohen para GJDBE-së dhe Gjykatës së Përgjithshme.

Në Modulin 2 trajtohen temat e mëposhtme:

- a) Fusha e zbatimit të nenit 267 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dhe kompetencat e GJDBE-së në interpretimin dhe zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian;
- b) Regjimi gjuhësor në procedurat para GJDBE-së;
- c) Tre fazat e procedurës së kërkesës për vendim paraprak para GJDBE-së:

1. Faza e parë: Gjykata kombëtare mundet, dhe në raste të caktuara duhet, t'i drejtohet GJDBE-së për të sqaruar interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian.
 - a) Roli i gjykatës më të lartë kombëtare dhe i gjykatave më të ulëta në procedurën e kërkesës për vendim paraprak: kur një gjykatë kombëtare mund, ose duhet, kur vendimi i saj nuk i nënshtrohet një mjeti juridik, të paraqesë një pyetje nëse një vendim mbi të drejtën e BE-së është i nevojshëm për dhënien e vendimit në çështje;
 - b) Zbatimi i kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën CILFIT: vlerësimi nëse ekziston një situatë *acte clair* ose *acte éclairé*, që ndikon në nevojën për paraqitjen e pyetjeve pranë GJDBE-së;
 - c) Refuzimi i gjykatës kombëtare për të paraqitur një kërkesë për vendim paraprak dhe detyrimi për arsyetimin e këtij refuzimi në vendim, bazuar në jurisprudencën e GJDBE-së dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ);
 - d) Roli i palëve në procedurën kombëtare dhe në procedurën e kërkesës për vendim paraprak;
 - e) Roli i gjykatës kombëtare në procedurën e kërkesës për vendim paraprak.
2. Faza e dytë: GJDBE-ja përcakton mënyrën e interpretimit të normës përkatëse të së drejtës së Bashkimit Evropian.
3. Faza e tretë: GJDBE-ja ia rikthen çështjen gjykatës kombëtare, e cila vendos mbi themelin e mos-marrëveshjes duke marrë parasysh interpretimin e dhënë nga Gjykata.

Në Modulin 3 trajtohen temat e mëposhtme:

- a) Kërkesa për vendim paraprak – konsiderata praktike për paraqitjen e saj;
- b) Rekomandimet drejtuar gjykatave kombëtare lidhur me fillimin e procedurës së kërkesës për vendim paraprak;
- c) Roli i gjykatës kombëtare pas dhënies së vendimit nga GJDBE-ja.

Në Modulin 4 trajtohen temat e mëposhtme:

- a) Masat e përkohshme para GJDBE-së dhe Gjykatës së Përgjithshme;
- b) Procedurat e përshpejtuara dhe urgjente: Procedura e Përshpejtuar (PPA), Procedura Paraprake Urgjente (PPU) dhe trajtimi me përparësi;
- c) Gjykata e Përgjithshme dhe kompetencat e saj në lidhje me procedurat e kërkesës për vendim paraprak.

Metodologjia e kursit / elementet kryesore

- » Kursi do të zhvillohet nga ekspertë juridikë, të cilët do të trajtojnë temat kryesore përmes analizës së rasteve konkrete dhe shembujve nga praktika gjyqësore.
- » Fokusi i kursit do të jetë ndërveprimi ndërmjet së drejtës së Bashkimit Evropian dhe së drejtës kombëtare në kuadër të një rendi juridik të përbashkët. Lektorët do të trajtojnë ndikimin dhe efektin e drejtpërdrejtë të së drejtës së BE-së në sistemet juridike kombëtare.
- » GJDBE-ja ka publikuar rekomandime specifike (të disponueshme në platformën CURIA), të cilat përbëjnë bazën metodologjike për paraqitjen e pyetjeve paraprake.
- » Gjatë leksioneve do të prezantohet funksionimi i faqes zyrtare të GJDBE-së (CURIA), si dhe llojet e informacionit që mund të gjenden në të, duke përfshirë vendimet, opinionet, çështjet në shqyrtim, vendimet përfundimtare të gjykatave kombëtare, studimet dhe raportet e qendrave kërkimore dhe të zhvillimit të njohurive.
- » Pjesëmarrësve do t'u vihen në dispozicion udhëzime praktike për formulimin e pyetjeve paraprake drejtuar GJDBE-së.
- » Të gjitha sesionet do të pasohen nga diskutime, pyetje dhe përgjigje (Q&A), si dhe shkëmbim përvojash profesionale ndërmjet pjesëmarrësve.

Hyrje

Procedura e kërkesës për vendim paraprak parashikohet në nenin 267 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dhe synon të garantojë interpretimin dhe zbatimin uniform të së drejtës së Bashkimit Evropian në të gjitha shtetet anëtare. Kjo procedurë u ofron gjykatave dhe tribunaleve kombëtare mundësinë për t'i drejtuar Gjykatës së Drejtësisë pyetje lidhur me interpretimin ose vlefshmërinë e së drejtës së Bashkimit Evropian, kur një vendim i GjDBE-së është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete në shqyrtim.

Për këtë arsye, kur lindin çështje lidhur me interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian, nuk u takon gjykatave penale kombëtare t'i zgjidhin vetë përfundimisht ato. Interpretimi i direktivave, i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, i parimeve të tjera përkatëse, si dhe i boshllëqeve të mundshme në kuadrin legjislativ të Bashkimit Evropian, kryhet nga GjDBE-ja përmes vendimeve paraprake mbi pyetjet që i paraqiten nga gjykatat dhe tribunalet e shteteve anëtare në përputhje me nenin 267 TFBE.

1. Moduli 1: Hyrje në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe burimet digjitale

Objektivat e të nxënit

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë rolin dhe strukturën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe të Gjykatës së Përgjithshme;
- të dallojnë llojet kryesore të procedurave para GjDBE-së;
- të përdorin CURIA dhe EUR-Lex për të identifikuar jurisprudencën përkatëse dhe dokumentet e Bashkimit Evropian;
- të identifikojnë burimet kryesore relevante për procedurat e kërkesës për vendim paraprak.

1.1 Mbi Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian është institucioni gjyqësor i Bashkimit Evropian.

Ajo përbëhet nga dy gjykata:

1. Gjykata e Drejtësisë;
2. Gjykata e Përgjithshme.

Misioni i saj është të interpretojë dhe të garantojë zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian. Gjykata siguron që institucionet e Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të respektojnë të drejtën e BE-së dhe ofron një interpretim të njëtrajtshëm të saj, në mënyrë që ajo të zbatohet njësoj në të gjithë Bashkimin Evropian.

1.1.1 Çfarë bën Gjykata?

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian është themeluar në vitin 1952.

Funksionet e saj kryesore janë:

- kontrollon ligjshmërinë e akteve dhe vendimeve të Bashkimit Evropian;
- siguron respektimin e së drejtës së BE-së nga shtetet anëtare dhe institucionet evropiane;
- u përgjigjet pyetjeve të paraqitura nga gjykatat kombëtare kur këto kanë nevojë për interpretim të së drejtës së BE-së ose kur ekzistojnë dyshime mbi vlefshmërinë e një akti të Bashkimit.

1.1.2 Funksionet kryesore dhe llojet e çështjeve që shqyrton GJDBE

1. Procedurat e vendimeve paraprake: Gjykata u përgjigjet pyetjeve të gjykatave kombëtare lidhur me interpretimin ose vlefshmërinë e së drejtës së BE-së, me qëllim garantimin e zbatimit uniform të saj.
2. Paditë për anulim: Gjykata mund t'i shpallë të paligjshme aktet e Bashkimit Evropian nëse ato cenojnë Traktatet e BE-së ose të drejtat themelore.
3. Paditë për mosveprim: Gjykata shqyrton nëse një institucion i Bashkimit Evropian ka dështuar të veprojë kur ka qenë i detyruar ta bëjë këtë.
4. Procedurat për shkelje të detyrimeve: Gjykata siguron respektimin e së drejtës së BE-së nga shtetet anëtare, zakonisht pas padive të ngritura nga Komisioni Evropian.
5. Ankimet: Gjykata shqyrton ankimet që ngrihen vetëm për çështje juridike kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme.

1.1.3 Kompetencat kryesore të Gjykatës së Përgjithshme

1. Paditë për anulim: Shqyrton paditë për anulim ose për mosveprim, të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë kundër institucioneve, agjencive ose organeve të BE-së.
2. E drejta e konkurrencës dhe tregtisë: Trajton çështje që lidhen me konkurrencën, ndihmën shtetërore, tregtinë dhe pronësinë intelektuale (p.sh., markat tregtare).
3. Paditë e Shteteve Anëtare: Shqyrton paditë e paraqitura nga Shtetet Anëtare kundër Komisionit Evropian ose Këshillit lidhur me fusha specifike, si ndihma shtetërore ose dumping-u.
4. Çështjet e dëmshpërblimit: Vendos mbi çështjet që kërkojnë kompensim për dëme të shkaktuara nga institucionet e BE-së.
5. Kërkesat për vendim paraprak: Administron kërkesa specifike për vendim paraprak të transferuara nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh., TVSH, doganat).

1.1.4 Faqja zyrtare CURIA

Faqja CURIA është portali zyrtar i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE). Ajo ofron akses në jurisprudencë, procedurat gjyqësore dhe platformën e-Curia për paraqitjen elektronike të dokumenteve

Link: <https://curia.europa.eu/site/>

- **Ndjekja e çështjeve (Case Tracking):** Baza e të dhënave të jurisprudencës përmban të gjitha kërkesat, vendimet dhe dokumentet juridike.

Link: https://curia.europa.eu/site/jcms/d2_5106/en/case-tracking-publicly-available-information

- **e-Curia:** Ky aplikacion përdoret për shkëmbimin elektronik të dokumenteve. Përdorimi i tij është i detyrueshëm për disa procedura dhe ofrohet pa pagesë.

- **Informacion mbi funksionimin e GJDBE-së:** https://curia.europa.eu/site/jcms/d2_5108/en/how-the-procedure-works
- **Seancat gjyqësore:** Seancat më të rëndësishme dhe shpallja e vendimeve transmetohen drejtpërdrejt në faqen zyrtare.

1.1.5 Faqja EUR-Lex

EUR-Lex është baza zyrtare elektronike e së drejtës së Bashkimit Evropian, e cila ofron akses falas dhe të përditësuar në dokumentet juridike të BE-së në të 24 gjuhët zyrtare të Bashkimit. Platforma administrohet nga Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian dhe përmban informacion të plotë, duke filluar nga traktatet themeluese deri te masat kombëtare të transpozimit.

- E drejta e Bashkimit Evropian (Traktate, Rregullore, Direktiva dhe Vendime);
- Jurisprudenca: Dokumente të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, duke përfshirë vendimet, urdhrat dhe opinionet e Avokatëve të Përgjithshëm;
- Dokumente përgatitore: Propozime legjislative, raporte, libra të gjelbër dhe libra të bardhë;
- Procedurat legjislative të Bashkimit Evropian: Informacion i detajuar dhe kronologjik mbi etapat e procesit legjislativ, nga paraqitja e propozimit deri në miratimin përfundimtar;
- Marrëveshjet ndërkombëtare të Bashkimit Evropian.

1.1.6 Karakteristikat & funksionalitetet kryesore

- Numrat CELEX: Çdo dokument identifikohet përmes një numri unik CELEX, i cili është i pavarur nga gjuha e dokumentit.
- Identifikuesit ELI/ECLI: Platforma mbështet Identifikuesin Evropian të Legjislacionit (ELI) dhe Identifikuesin Evropian të Jurisprudencës (ECLI), duke mundësuar lokalizimin e saktë të dokumenteve.
- Shfaqja shumëgjuhëshe: Lejon shfaqjen e një dokumenti në deri në tre versione gjuhësore njëkohësisht.
- Kërkimi i avancuar dhe njoftimet automatike: Ofron kërkim të shpejtë, të avancuar dhe ekspert (duke përdorur operatorë Boolean), si dhe mundëson që përdoruesit e regjistruar të ruajnë kërkimet dhe të marrin njoftime përmes RSS.
- Akses në N-Lex: Ofron lidhje me platformën N-Lex, e cila mundëson akses në legjislacionin kombëtar të shteteve evropiane.

Përmbledhje e pikave kryesore

Procedura e kërkesës për vendim paraprak bazohet në bashkëpunimin ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) dhe synon të garantojë interpretimin dhe zbatimin e njëtrajtshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian në të gjitha shtetet anëtare.

2. Moduli 2: Procedura e vendimit paraprak

Objektivat e të nxënës

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë qëllimin dhe fazat e procedurës së kërkesës për vendim paraprak;
- të identifikojnë rastet kur një gjykatë kombëtare mund ose duhet t'i drejtohet GJDBE-së me pyetje paraprake;
- të zbatojnë në praktikë kriteret e përcaktuara në jurisprudencën CILFIT;
- të kuptojnë rolin e gjykatave kombëtare, të palëve në proces dhe të GJDBE-së gjatë procedurës së kërkesës për vendim paraprak.

2.1 Qëllimi i procedurës së kërkesës për vendim paraprak

Gjatë vitit 2025 u përfunduan gjithsej 774 çështje:

- 561 procedura të kërkesës për vendim paraprak, duke përfshirë 3 procedura urgjente për vendim paraprak;
- 51 padi të drejtpërdrejta, ndër të cilat 38 vendime që konstatuan mospërbushjen e detyrimeve nga 20 shtete anëtare;
- 5 vendime që konstatuan një “mospërbushje të dyfishtë të detyrimeve”;
- 156 ankime kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme, përfshirë raste në të cilat vendimi i Gjykatës së Përgjithshme u shfuqizua.

Kohëzgjatja mesatare e procedurave:

- 16.7 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e procedurave urgjente për vendim paraprak (PPU):

- 3.4 muaj.

Numri i çështjeve në pritje më 31 dhjetor 2025:

- 1322 çështje.

2.1.1 Çështjet kryesore të trajtuara nga GJDBE në vitin 2025

Zona	Numri i subjekteve
Hapësira e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë	142
Ndihma shtetërore dhe konkurrenca	132
Politika ekonomike dhe monetare	111
Liria e lëvizjes dhe e vendosjes – tregu i brendshëm	106
Mbrojtja e konsumatorit	95
Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë	79
Përafrimi i legjislacionit	76
Mjedisi	63
Politika sociale	52
Transporti	47

- Këto statistika pasqyrojnë rëndësinë thelbësore të procedurës së kërkesës për vendim paraprak në sistemin juridik të Bashkimit Evropian. E drejta e BE-së funksionon përmes një sistemi të zbatimit të decentralizuar, ku gjykatat kombëtare përbëjnë mekanizmin kryesor për garantimin e respektimit të saj.
- Megjithatë, përcaktimi i natyrës dhe përmbajtjes së saktë të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga aktet e Bashkimit Evropian nuk u takon vetëm gjykatave kombëtare. Interpretimi i Traktateve, Direktivave dhe akteve të tjera të së drejtës së BE-së është kompetencë e GJDBE-së.
- Në kuadër të sistemit gjyqësor të decentralizuar të Bashkimit Evropian, procedura e kërkesës për vendim paraprak shërben si një mekanizëm për promovimin e unitetit juridik dhe zhvillimin e së drejtës së BE-së, duke krijuar një dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet gjykatave kombëtare dhe GJDBE-së.
- GJDBE-ja nuk ka kompetencë të interpretojë të drejtën kombëtare të shteteve anëtare (Çështja C-6/64, Costa kundër ENEL). Nëse gjykata kombëtare formulon pyetjen në mënyrë të tillë që kërkon nga GJDBE-ja të vlerësojë vlefshmërinë e së drejtës kombëtare, Gjykata mund të deklarojë mungesën e kompetencës së saj për të shqyrtuar çështjen.
- Gjithashtu, GJDBE-ja shqyrton vetëm pyetje paraprake që lidhen me një mosmarrëveshje konkrete dhe reale. Çështjet hipotetike, pavarësisht interesit teorik që mund të paraqesin, nuk merren në shqyrtim nga Gjykata (shih, ndër të tjera, Çështjen C-83/91, Meilicke, dhe Çështjen C-156/23, Ararat).


2.2 Regjimi gjuhësor

- Një tipar i rëndësishëm i procedurës është gjuha e çështjes. Mundësia për ta paraqitur një çështje në gjykatë në një gjuhë që e kuptoni dhe për të qenë në gjendje të lexoni vendimet gjyqësore është pjesë themelore e demokracisë dhe e shtetit të së drejtës. Gjuha e punës e GJDBE-së është frëngjishtja dhe të gjitha dokumentet do të përkthehen në frëngjisht nga GJDBE-ja. Megjithatë, çdo çështje ka gjithashtu ‘gjuhën e çështjes’ së vet.
- Në procedurat e kërkesës për vendim paraprak, gjuha e çështjes është gjuha e gjykatës ose tribunilit që ka paraqitur kërkesën. Kjo u mundëson palëve në procedurën para gjykatës kombëtare të paraqesin vërejtjet e tyre me shkrim dhe me gojë në atë gjuhë.
- Prandaj, Gjykata e Drejtësisë punon në të 24 gjuhët zyrtare të BE-së. I gjithë komunikimi me palët kryhet në gjuhën e çështjes. Në paditë e drejtpërdrejta, gjuha e çështjes është gjuha e zgjedhur nga paditësi. Nëse i padituri është një Shtet Anëtar i BE-së, ajo duhet të jetë një nga gjuhët zyrtare të atij Shteti. Në ankimet, gjuha e çështjes është gjuha në të cilën është dhënë vendimi i Gjykatës së Përgjithshme.

2.3 Tre fazat e procedurës

GJDBE-ja ka miratuar një sërë Rekomandimesh drejtuar gjykatave kombëtare lidhur me fillimin e procedurave të kërkesës për vendim paraprak (“Rekomandimet”). Ky material mbështetet në këto Rekomandime, në Rregulloren e Procedurës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (“Rregullorja e Procedurës”), në jurisprudencën përkatëse, si dhe në burime të tjera relevante, me qëllim ofrimin e një pasqyre praktike të procedurës së kërkesës për vendim paraprak për profesionistët e së drejtës.

Kur një gjykatë kombëtare shqyrton një çështje që ngre pyetje lidhur me interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian, ajo mundet, dhe në raste të caktuara duhet, t’i drejtohet GJDBE-së për të sqaruar interpretimin e normës së së drejtës së BE-së (Faza 1). Më pas, Gjykata e Drejtësisë përcakton mënyrën e interpretimit të dispozitës përkatëse të së drejtës së Bashkimit Evropian (Faza 2) dhe ia rikthen çështjen gjykatës kombëtare, e cila vendos mbi themelin e mosmarrëveshjes duke marrë në konsideratë interpretimin e dhënë nga Gjykata (Faza 3). Secila prej këtyre fazave trajtohet në vijim të këtij moduli.



2.3.1 Karakteristikat kryesore të procedurës së kërkesës për vendim paraprak

- Që të jetë e mundur paraqitja e një kërkesë për vendim paraprak, duhet të ekzistojë një çështje e së drejtës së Bashkimit Evropian për të cilën një vendim i GJDBE-së është i nevojshëm që gjykata kombëtare të mund të japë vendimin e saj.
- Koha mesatare për marrjen e një vendimi mbi një kërkesë për vendim paraprak është rreth 15-18 muaj.
- Ekziston një procedurë urgjente (PPU – Procedura Paraprake Urgjente) e parashikuar në nenin 267, paragrafi i katërt, të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dhe në nenet 107–114 të Rregullores së Procedurës së GJDBE-së. Kjo procedurë zbatohet veçanërisht kur personi i përfshirë ndodhet në paraburgim ose në ndalim dhe vendimi i GJDBE-së mund të ndikojë në ligjshmërinë apo vazhdimin e ndalimit, si dhe në rastet kur janë në lojë të drejtat e fëmijëve. Gjykata kombëtare duhet të kërkojë shprehimisht zbatimin e procedurës urgjente, duke paraqitur arsyet përkatëse.
- Në bazë të nenit 267 TFBE, gjykata kombëtare ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për vendim paraprak në çdo fazë të procedurës kombëtare. Çdo dispozitë e së drejtës kombëtare që pengon ushtrimin e kësaj të drejte duhet të lihet pa zbatim.
- Përveç gjykatave të zakonshme, edhe një gjyqtar hetues mund t'i drejtohet GJDBE-së me një kërkesë për vendim paraprak. Megjithatë, prokurori nuk gëzon një kompetencë të tillë.
- Gjykatat e shkallës së fundit cenojnë nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KED-NJ) dhe nenin 267 të TFBE-së në lidhje me nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian nëse refuzojnë t'i drejtohen GJDBE-së pa dhënë arsyetim përkatës lidhur me një çështje të së drejtës së BE-së. Gjykatat Kushtetuese në disa shtete (si, për shembull, Gjermania dhe Sllovenia) e konsiderojnë refuzimin e pajustifikuar për t'i drejtuar një pyetje GJDBE-së si shkelje të së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga gjykata e caktuar me ligj ("gjyqtari ligjor"). Mundësia për t'iu drejtuar individualisht Gjykatës Kushtetuese nuk konsiderohet një mjet tjetër gjyqësor. Për rrjedhojë, një gjykatë e shkallës së fundit është e detyruar t'i drejtohet GJDBE-së kur çështja nuk përbën një rast *acte clair* ose *acte éclairé*, sipas standardeve të përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës.

2.3.2 Faza 1 e procedurës: Para gjykatës ose tribunalit kombëtar

2.3.2.1 Kur është e dobishme të kërkohej një vendim paraprak?

Gjykatat kombëtare kanë detyrimin të zbatojnë të drejtat e BE-së që kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe të lënë mënjë të drejtën dhe praktikën kombëtare që mund të bien ndesh me këto të drejta. Objektivi i parë i të paditurit është që gjykata kombëtare të mos zbatojë legjislacionin ose praktikën kombëtare që bie ndesh me të drejtën e BE-së dhe të zbatojë drejtpërdrejt rregullat e BE-së që janë më të favorshme. Në këtë drejtim, palët ndërgjyqëse duhet të tregojnë se e drejta e BE-së është e qartë dhe se ajo zbatohet në rastin e tyre. Në këtë drejtim, ndonjëherë është e dobishme që gjykata të bindet për kuptimin e qartë të një dispozite të së drejtës së BE-së duke përdorur vendime të gjykatave të huaja që i japin të njëjtin kuptim. Vetëm kur gjykata kombëtare nuk është e gatshme ta interpretojë të drejtën e BE-së sipas mënyrës së sugjeruar nga i padituri, kërkimi i një referimi mund të bëhet i dobishëm. Në atë moment, është e nevojshme t'i tregohet gjykatës kombëtare se ekziston një pyetje ose dyshim lidhur me kuptimin e saktë të së drejtës së BE-së dhe se kjo duhet të zgjidhet nga GJDBE-ja.

Kompetenca për të referuar një pyetje paraprake i përket ekskluzivisht gjykatës kombëtare, pavarësisht nëse palët e kanë kërkuar këtë në procedurën kryesore. Vlerësimi i nevojës për të referuar një pyetje paraprake dhe i rëndësisë së saj bie në kompetencën ekskluzive të gjykatës kombëtare së cilës i është paraqitur mosmarrëveshja.

2.3.2.2 Kush e paraqet kërkesën?

- Palët në një proces gjyqësor kombëtar nuk mund t'i drejtohen vetë dhe drejtpërdrejt GJDBE-së me një kërkesë për vendim paraprak.
- Vendimi nëse do të paraqitet ose jo një kërkesë për vendim paraprak i takon vetëm gjykatës kombëtare.
- Gjykatat dhe tribunalet kombëtare të çdo shkalle gëzojnë diskrecionin për t'iu drejtuar GJDBE-së me një kërkesë për vendim paraprak. Një gjykatë më e lartë nuk mund ta pengojë një gjykatë më të ulët të ushtrijë këtë kompetencë. Po ashtu, nuk kërkohet pëlqimi i palëve për paraqitjen e kërkesës.
- Çdo "gjykatë ose tribunal" i një shteti anëtar mund të paraqesë një pyetje paraprake. Gjykata e Drejtësisë ka pranuar gjithashtu pyetje të paraqitura nga organe të krijuara posaçërisht (ad hoc). Kur çështja e së drejtës së Bashkimit Evropian lind përpara një gjykate, vendimet e së cilës nuk i nënshtrohen mjeteve të zakonshme të ankimit, referimi i çështjes në GJDBE është i detyrueshëm.
- Vetëm organet gjyqësore të shteteve anëtare janë kompetente të paraqesin kërkesa për vendim paraprak. Ky koncept nuk është i përkufizuar shprehimisht në Traktate, por jurisprudenca e Gjykatës ka zhvilluar një sërë kriteresh për të përcaktuar nëse një organ mund të konsiderohet organ gjyqësor (Çështja C-54/96, Dorsch Consult; shih gjithashtu Çështjen C-115/22). Këto kriterë janë:
 1. organi duhet të jetë i pavarur, i krijuar rregullisht sipas së drejtës kombëtare, të ketë karakter të përhershëm dhe juridiksion të detyrueshëm; dhe
 2. organi duhet të vendosë në përputhje me rregullat e së drejtës pas një procedure kontradiktore ndërmjet palëve.

Arbitrazhet nuk i përmbushin këto kriterë (Çështja C-102/81, *Nordsee*), as organet administrative që shqyrtojnë ankime administrative (Çështja C-24/92, *Corbiau*). Për rrjedhojë, këto organe nuk mund t'i drejtohen Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian me kërkesa për vendim paraprak.

2.3.2.3 Në cilat rrethana mund të paraqitet një kërkesë për vendim paraprak?

- Kur lind një çështje që kërkon interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian, gjykata kombëtare duhet të vlerësojë nëse një vendim paraprak i GJDBE-së është i nevojshëm për t'i mundësuar asaj dhënien e vendimit në çështjen konkrete. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur jurisprudenca ekzistuese e GJDBE-së nuk ofron udhëzimet e nevojshme për zbatimin e një dispozite të së drejtës së BE-së ndaj një situate të re faktike.
- GJDBE-ja nuk u përgjigjet pyetjeve hipotetike. Për këtë arsye, është thelbësore që sqarimi i kërkuar të jetë i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes nga gjykata kombëtare.
- Pyetjet lidhur me interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian, të paraqitura nga një gjykatë kombëtare brenda kuadrit faktik dhe ligjor të përcaktuar prej saj, gëzojnë prezumimin e relevancës.
- GJDBE-ja mund të refuzojë t'i përgjigjet një pyetjeje paraprake vetëm kur është qartësisht e dukshme se interpretimi i kërkuar i së drejtës së Bashkimit Evropian nuk ka lidhje me faktet ose objektin e mosmarrëveshjes kryesore, kur problemi i ngritur është hipotetik, ose kur Gjykata nuk disponon elementët faktikë apo juridikë të nevojshëm për të dhënë një përgjigje të dobishme ndaj pyetjeve të paraqitura.
- Në bazë të nenit 267 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), GJDBE-ja ka kompetencë të japë vendime paraprake lidhur me interpretimin e Traktateve dhe të së drejtës dytësore të Bashkimit Evropian, përfshirë direktivat e BE-së mbi të drejtat procedurale. Është e rëndësishme të theksohet se gjykata kombëtare nuk mund t'i formulojë pyetjet paraprake duke u mbështetur ekskluzivisht në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Pyetjet duhet t'i referohen së drejtës së Bashkimit Evropian.

Për t'u mbajtur parasysh


Paraqitja e një kërkesë për vendim paraprak mund të mos jetë gjithmonë zgjidhja më e përshtatshme kur ekziston një konflikt ndërmjet interesit individual të të pandehurit dhe objektivave strategjike të çështjes që synon referimi. Ndër faktorët që duhen marrë në konsideratë është fakti se procedura e kërkesës për vendim paraprak mund të zgjasë më shumë se një vit dhe, si rrjedhojë, të vonojë zgjidhjen e një çështjeje që përndryshe mund të përfundonte më shpejt në nivel kombëtar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur i pandehuri ndodhet në paraburgim ose në ndalim.

2.3.2.4 Si përcaktohen pyetjet paraprake?

- Hartimi i pyetjeve paraprake është kompetencë e gjykatës kombëtare. Pasi gjykata arrin në përfundimin se një vendim paraprak është i nevojshëm, ajo mund t'i ftojë palët të paraqesin qëndrimet e tyre lidhur me pyetjet që do t'i drejtohen GJDBE-së. Kjo përbën një mundësi të rëndësishme për palët që të ndikojnë në formulimin e pyetjeve përpara se ato t'i paraqiten Gjykatës.
- Megjithatë, forma përfundimtare dhe përmbajtja e kërkesës për vendim paraprak përcaktohen ekskluzivisht nga gjykata kombëtare.

2.3.2.5 A është procedura e kërkesës për vendim paraprak fakultative apo e detyrueshme?

Vendimi për t'i drejtuar një pyetje paraprake GJDBE-së është, si rregull, në diskrecionin e gjykatës kombëtare. I takon vetëm gjykatës para së cilës është paraqitur mosmarrëveshja dhe e cila mban përgjegjësinë për vendimin përfundimtar në çështje, të vlerësojë, në dritën e rrethanave konkrete të rastit, si nevojën për një vendim paraprak për të qenë në gjendje të japë vendimin e saj, ashtu edhe rëndësinë e pyetjeve që i paraqiten GJDBE-së.



2.3.2.6 A ekziston e drejta për një vendim paraprak kur bëhet fjalë për interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian?

Sipas nenit 267(3) të TFBE-së, një gjykatë kombëtare e shkallës së fundit duhet t'i kërkojë GJDBE-së një vendim paraprak kur ekziston një pyetje e mirëfilltë interpretimi.

Kriteret CILFIT burojnë nga çështja historike e vitit 1982, Srl CILFIT kundër Ministrisë së Shëndetësisë (283/81), e cila përcakton kushtet në të cilat një gjykatë kombëtare e shkallës së fundit përjashtohet nga detyrimi i saj për t'i referuar Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE) pyetje të së drejtës së BE-së.

2.3.2.7 Tre përjashtimet kryesore sipas doktrinës CILFIT

1. **Pyetja nuk është relevante për zgjidhjen e çështjes:** Përgjigjja ndaj pyetjes së së drejtës së Bashkimit Evropian nuk ka asnjë ndikim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Në këtë rast, interpretimi i kërkuar nuk është i nevojshëm për dhënien e vendimit.
2. **Acte Éclairé (jurisprudencë e konsoliduar):** Pyetja e ngritur është në thelb identike me një çështje që është shqyrtuar tashmë nga Gjykata e Drejtësisë në një çështje të ngjashme, ose pika juridike përkatëse është zgjidhur tashmë nga jurisprudenca e konsoliduar e GJDBE-së.
3. **Acte Clair (interpretim i qartë):** Zbatimi i saktë i së drejtës së Bashkimit Evropian është aq i qartë dhe i dukshëm sa nuk lë vend për asnjë dyshim të arsyeshëm lidhur me interpretimin e saj.

Përjashtimi	Kuptimi	A kërkohet referimi në GJDBE?
Pyetje jo relevante	E drejta e BE-së nuk është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes	Jo
<i>Acte éclairé</i>	Çështja është sqaruar tashmë nga jurisprudenca e GJDBE-së	Jo
<i>Acte clair</i>	Interpretimi i saktë i së drejtës së BE-së nuk lë vend për asnjë dyshim të arsyeshëm	Jo

- Në vendimin e vitit 2021 në çështjen *Consorzio Italian Management (C-561/19)*, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian konfirmoi dhe sqaroi më tej kriteret CILFIT:

1. **Detyrimi për arsyetim:** Megjithëse gjykatat e shkallës së fundit gëzojnë diskrecion për të mos paraqitur një kërkesë për vendim paraprak, ato kanë detyrimin e rreptë të shpjegojnë arsyet pse konsiderojnë se zbatohet një nga përjashtimet e njohura nga jurisprudenca CILFIT (pra, pse çështja përbën një rast *acte clair* ose *acte éclairé*).
2. **Verifikimi i versioneve gjuhësore:** Gjykatat nuk janë të detyruara të shqyrtojnë të gjitha versionet gjuhësore të dispozitës së së drejtës së Bashkimit Evropian, por duhet të marrin në konsideratë çdo mospërputhje gjuhësore për të cilën janë në dijeni ose që u janë vënë në dukje.
3. **Mospërputhjet me gjykatat më të ulëta:** Fakti që një gjykatë më e ulët ka interpretuar ndryshe një dispozitë të së drejtës së Bashkimit Evropian nuk nënkupton domosdoshmërisht se një gjykatë supreme nuk mund ta konsiderojë çështjen si *acte clair*, për sa kohë që ajo kryen analizën përkatëse.

2.3.2.8 Arsyetimi në vendim kur gjykata kombëtare nuk paraqet kërkesë për vendim paraprak

Gjykatat e shkallës së fundit shkelin nenin 6 të KEDNJ-së nëse nuk japin arsyetim për refuzimin për t'i drejtuar GJDBE-së një pyetje lidhur me të drejtën e BE-së (GJEDNJ, 9 tetor 2013, *Dhahbi kundër Italisë, kërkesa nr. 17120/09*). Për më tepër, në disa shtete anëtare, detyrimi i gjykatave të shkallës së fundit për të paraqitur kërkesa për vendim paraprak përforcohet edhe nga garanci kushtetuese, të cilat i japin palës së prekur mundësinë të paraqesë ankim kushtetues kundër një refuzimi arbitrar për t'iu drejtuar GJDBE-së.

Në vendimin e saj në Çështjen C-767/23, Remling, Gjkata theksoi se një gjykatë ose tribunal i shkallës së fundit duhet gjithmonë të japë arsyet për refuzimin e saj për t'i drejtuar Gjykatës së Drejtësisë një kërkesë për vendim paraprak.

Edhe kur legjislacioni kombëtar lejon që një çështje të rrëzohet përmes një arsyetimi të përmbledhur, gjykata është e detyruar të shpjegojë në mënyrë specifike dhe konkrete arsyet pse konsideron se zbatohet një nga përjashtimet nga detyrimi për referim paraprak.

Në këtë çështje, Gjkata shqyrtoi përputhshmërinë me të drejtën e Bashkimit Evropian të një dispozite të së drejtës holandeze që i lejonte gjykatës supreme të rrëzonte një ankim vetëm mbi bazën e një arsyetimi të shkurtër. Kjo dispozitë synonte të siguronte administrimin e mirë të drejtësisë, duke reduktuar kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe duke i mundësuar gjykatës supreme të përqendrohej në çështje me rëndësi më të madhe. Pasi nënvizoi rolin themelor të procedurës së kërkesës për vendim paraprak në sistemin gjyqësor të Bashkimit Evropian, Gjkata rikujtoi se një gjykatë e shkallës së fundit është e detyruar të paraqesë një kërkesë për vendim paraprak, përveç rasteve kur pyetja e së drejtës së Bashkimit Evropian është e parëndësishme për zgjidhjen e çështjes, kur dispozita përkatëse e së drejtës së Bashkimit Evropian është interpretuar tashmë nga Gjkata, ose kur interpretimi i dispozitës është aq i qartë sa nuk lë vend për asnjë dyshim të arsyeshëm. Kur një gjykatë e shkallës së fundit konsideron se ndodhet në njërën prej këtyre situatave, ajo duhet të shpjegojë në mënyrë specifike dhe konkrete arsyet pse nuk është e nevojshme t'i drejtohet GJDBE-së. Për këtë qëllim, gjykata mund të mbështetet edhe në arsyetimin e një gjykate më të ulët që ka shqyrtuar të njëjtën çështje, me kusht që kjo e fundit të ketë shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme pse rasti përfshihet në njërën prej tre përjashtimeve të sipërpërmendura.

2.3.2.9 Referimi i detyrueshëm: Vlefshmëria e së drejtës së Bashkimit Evropian

Në çështjen Foto-Frost kundër Hauptzollamt Lübeck-Ost (Çështja 314/85), Gjkata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian vendosi se gjykatat kombëtare nuk kanë kompetencë të deklarojnë të pavlefshme aktet e institucioneve të Bashkimit Evropian. Nëse një gjykatë kombëtare ka dyshime lidhur me vlefshmërinë e një akti të Bashkimit Evropian, ajo është e detyruar t'ia paraqesë këtë çështje Gjykatës së Drejtësisë nëpërmjet procedurës së kërkesës për vendim paraprak sipas nenit 267 TFBE. Kjo garanton zbatimin e njëtrajtshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian.

2.3.2.10 2.3.2.10. Elementet kryesore të doktrinės Foto-Frost

1. **Kompetenca ekskluzive:** Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian gëzon kompetencë ekskluzive për të deklaruar të pavlefshëm një akt të Bashkimit Evropian.
2. **Detyrimi për referim:** Edhe gjykatat e shkallëve më të ulëta (dhe jo vetëm gjykatat e shkallës së fundit) janë të detyruara t'i drejtohen GJDBE-së kur konsiderojnë se argumentet kundër vlefshmërisë së një akti të Bashkimit Evropian janë të bazuara.
3. **Funksioni parandalues:** Ky parim siguron që e drejta e Bashkimit Evropian të mos zbatohet në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme anëtare.
4. **Përjashtimi – Masat e përkohshme:** Në rrethana shumë të kufizuara, gjykatat kombëtare mund të urdhërojnë masa të përkohshme për pezullimin e zbatimit të një akti të Bashkimit Evropian deri në momentin kur GJDBE-ja të japë vendimin e saj mbi vlefshmërinë e aktit, me kusht që çështja t'i jetë referuar Gjykatës.

Doktrina Foto-Frost është thelbësore për ruajtjen e “sistemit të plotë të mjeteve juridike” në të drejtën e Bashkimit Evropian, duke garantuar që çdo kundërshtim ndaj vlefshmërisë së një akti të BE-së të shqyrtohet nga Gjykata e Drejtësisë dhe jo nga gjykatat kombëtare.

- Gjykatat e shkallës së fundit cenojnë nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian nëse refuzojnë t'i drejtohen GJDBE-së pa dhënë arsytim përkatës lidhur me një çështje të së drejtës së Bashkimit Evropian.
- Për më tepër, në disa shtete anëtare, detyrimi i gjykatave të shkallës së fundit për të paraqitur kërkesa për vendim paraprak përforcohet edhe nga garanci kushtetuese, të cilat i japin palës së prekur të drejtën të ankimojë në gjykatën kushtetuese kundër një refuzimi arbitrar për t'iu drejtuar GJDBE-së.

2.3.2.11 Çfarë ndodh nëse gjykata më e lartë kombëtare nuk i drejtohet GJDBE-së? Pasojat dhe rreziqet

- Dyshimet e gjykatave më të ulëta nuk e detyrojnë automatikisht gjykatën supreme të paraqesë një kërkesë për vendim paraprak. Megjithatë, kur ekziston rreziku i zhvillimit të jurisprudencës divergjente brenda Bashkimit Evropian, gjykata supreme është e detyruar t'i drejtohet GJDBE-së. Kjo situatë paraqitet, për shembull, kur gjykata të shteteve të ndryshme anëtare i janë drejtuar në mënyrë të përsëritur GJDBE-së lidhur me të njëjtën temë (Çështja C-160/14, *J.F. Ferreira da Silva e Brito* dhe të tjerë).
- Nëse gjykata supreme nuk ka vetë dyshime lidhur me interpretimin e saktë të së drejtës së Bashkimit Evropian, ajo nuk është e detyruar të presë përgjigjen e GJDBE-së ndaj pyetjeve të paraqitura nga një gjykatë tjetër dhe as të paraqesë vetë një kërkesë për vendim paraprak (Çështja C-197/14, *X dhe Van Dijk*).
- Në Çështjen C-416/17, Gjykata e Drejtësisë konstatoi se Conseil d'État francez kishte shkelur të drejtën e Bashkimit Evropian duke mos paraqitur pyetje paraprake lidhur me lirinë e lëvizjes së kapitalit, megjithëse ekzistonin dyshime të arsyeshme mbi interpretimin e dispozitave përkatëse.
- Çështja kishte të bënte me trajtimin fiskal të shoqërive mëmë franceze që merrnin dividendë nga shoqëri bija të vendosura jashtë Francës dhe me përputhshmërinë e këtij trajtimi me nenin 49 TFBE (liria e vendosjes) dhe nenin 63 TFBE (liria e lëvizjes së kapitalit). Komisioni Evropian nisi procedurë për shkelje kundër Francës, duke argumentuar se:

1. Conseil d'État kishte zbatuar legjislacionin francez në një mënyrë që shpërfillte vendimet e mëparshme të GJDBE-së mbi interpretimin e neneve 49 dhe 63 TFBE në këtë fushë;
 2. Duke mos paraqitur një kërkesë për vendim paraprak, ndonëse kishte dyshime lidhur me interpretimin e jurisprudencës së GJDBE-së, Conseil d'État kishte shkelur detyrimin që rrjedh nga neni 267(3) TFBE.
- Nëse një gjykatë supreme nuk paraqet një kërkesë për vendim paraprak në një rast kur ishte e detyruar ta bënte këtë, mund të lindë përgjegjësia e shtetit për shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian, me kusht që të përmbushen kriteret e rrepta të përcaktuara në jurisprudencën *Köbler*.

2.3.2.12 Kriteret për përgjegjësinë e shtetit: Çështja C-224/01 Gerhard Köbler kundër Republikës së Austrisë

Në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, janë përcaktuar tre kushte që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për të ngarkuar një shtet me përgjegjësi për shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian që i atribuohen atij.

Këto kushte zbatohen edhe kur shkelja e së drejtës së Bashkimit Evropian vjen nga një gjykatë kombëtare që gjykon në shkallë të fundit. Kushtet janë si më poshtë:

1. Norma juridike e shkelur duhet të synojë t'u japë të drejta individëve;
2. Shkelja duhet të jetë mjaftueshëm serioze;
3. Duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë shkakësore ndërmjet shkeljes së detyrimit që i ngarkohet shtetit dhe dëmit të pësuar nga individi.

2.3.3 Faza 2 e procedurës: para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

Fazat kryesore të procedurës përpara GJDBE-së:

2.3.3.1 Vendimi mbi urgjencën e procedurës

Nëse kërkohet procedura urgjente ose e përshpejtuar, GJDBE-ja do të nxjerrë shpejt një urdhër për të përcaktuar nëse zbatimi i kësaj procedure është i justifikuar. Zakonisht, paraburgimi do të justifikojë zbatimin e një procedure të përshpejtuar.

2.3.3.2 Parashtresat me shkrim

Pas regjistrimit të kërkesës për vendim paraprak në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, palët në procedurën kombëtare ftohen të paraqesin vërejtjet e tyre me shkrim. Këto mund të dorëzohen me postë pranë Sekretarisë së Gjykatës së Drejtësisë ose nëpërmjet platformës elektronike të Gjykatës, e-Curia.

2.3.3.3 Seanca dëgjimore

Në varësi të natyrës dhe nevojave të çështjes, Gjykata mund të zhvillojë një seancë dëgjimore, gjatë së cilës palët kanë mundësinë të paraqesin personalisht argumentet e tyre. Seanca është publike.

2.3.3.4 Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm

Pas paraqitjes së të gjitha vërejtjeve dhe parashtresave, Avokati i Përgjithshëm (*Advocate General – AG*) i cakton për çështjen paraqet opinionin e tij ose të saj. Avokati i Përgjithshëm paraqet opinion vetëm në rastet kur Gjykata vlerëson se çështja ngre një problematikë të re juridike. Megjithatë opinioni i Avokatit të Përgjithshëm nuk është detyrues për Gjykatën, në praktikë ai ndiqet shumë shpesh nga Gjykata në vendimin përfundimtar.

2.3.3.5 Vendimi i GJDBE-së dhe kthimi i çështjes në gjykatën referuese

Menjëherë pas paraqitjes së opinionit të Avokatit të Përgjithshëm, Gjykata jep vendimin e saj mbi kërkesën për vendim paraprak, duke iu përgjigjur pyetjeve të paraqitura nga gjykata kombëtare. Gjykata interpreton të drejtën e Bashkimit Evropian dhe, kur është e nevojshme, përcakton kriteret juridike që duhet të zbatohen, por nuk vendos vetë mbi themelin e mosmarrëveshjes. Pasi jepet vendimi i GJDBE-së, çështja i rikthehet gjykatës kombëtare referuese, e cila vendos mbi themelin e çështjes në përputhje me interpretimin e dhënë nga Gjykata.

2.3.3.6 Kur fillon procedura para GJDBE-së?

Pasi gjykata kombëtare vendos pezullimin e procedurës kombëtare, ajo i dërgon kërkesën për vendim paraprak Sekretarisë së Gjykatës së Drejtësisë në adresën e mëposhtme: Court of Justice of the European Union L-2925, Luxembourg, LUXEMBOURG.

Më pas, Sekretaria e Gjykatës njofton palët e interesuara për kërkesën e paraqitur dhe publikon një njoftim përkatës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

2.3.3.7 Sa zgjat procedura?

Paraqitja e një kërkesë për vendim paraprak kërkon pezullimin e procedurës kombëtare deri në momentin kur Gjykata e Drejtësisë jep vendimin e saj. Kohëzgjatja mesatare e procedurës së kërkesës për vendim paraprak është rreth 18 muaj.

Megjithatë, veçanërisht për praktikuesit e së drejtës penale, është e rëndësishme të theksohet se ekzistojnë Procedura e Përsheptuar (PPA) dhe Procedura Paraprake Urgjente (PPU), nga të cilat kjo e fundit përdoret shpesh në rastet kur një individ ndodhet në paraburgim ose i është kufizuar liria. Procedura urgjente trajtohet më në detaje në seksionet vijuese.

2.3.3.8 Kush merr pjesë në procedurën para GJDBE-së?

Të gjitha palët në procedurën kombëtare marrin pjesë edhe në procedurën para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, duke përfshirë çdo palë të tretë që është pjesë e procedimit në nivel kombëtar. Sipas nenit 23 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, pasi kërkesa për vendim paraprak regjistrohet në Sekretarinë e Gjykatës, ajo u njoftohet: shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian dhe institucionit të Bashkimit Evropian që ka miratuar aktin juridik interpretimi i të cilit kërkohet. Në rastin e Direktivave të BE-së mbi të Drejtat Procedurale, kjo nënkupton se njoftimi i dërgohet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Parlamentit Evropian. Këto subjekte gëzojnë të drejtën absolute për të paraqitur vërejtje në çështje, si me shkrim ashtu edhe gojarisht. Disa shtete anëtare mund të ndërhyjnë në procedurë kur vlerësojnë se vendimi i GJDBE-së mund të ketë pasoja ose ndikim mbi sistemin e tyre juridik. Komisioni Evropian ndërhyr gjithmonë në procedurat e kërkesave për vendim paraprak.

2.3.3.9 Ndërhyrja e palëve të treta në procedurat para GJDBE-së

Duhet të kihet parasysh se organizatat e shoqërisë civile, organizatat joqeveritare (OJQ-të) ose subjekte të tjera të treta nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në një procedurë para GJDBE-së nëse nuk janë palë në procedimin kombëtar. Nëse një palë e tretë dëshiron të paraqesë vërejtje formale para Gjykatës së Drejtësisë, ajo duhet të jetë bërë pjesë e procedurës kombëtare përpara se kërkesa për vendim paraprak t'i dërgohet GJDBE-së.

2.3.3.10 Cilat janë kostot e procedurës?

Procedura e kërkesës për vendim paraprak është pa pagesë. Çështja e shpërndarjes dhe mbulimit të kostove procedurale mbetet në kompetencën e gjykatës kombëtare që shqyrton çështjen.

2.3.3.11 A ekziston ndihma juridike falas?

Veçanërisht për praktikuesit e së drejtës penale, është e rëndësishme të theksohet se Gjykata e Drejtësisë mund të japë vetë ndihmë juridike falas, në masën që ndihma e përfituar sipas legjislacionit kombëtar nuk mbulon shpenzimet e krijuara gjatë procedurës para GJDBE-së. Sipas nenit 115 të Rregullores së Procedurës së Gjykatës së Drejtësisë, një palë në procedimin kryesor që nuk ka mundësi të përballojë kostot e procedurës para Gjykatës mund të paraqesë një kërkesë për ndihmë juridike falas. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna të detajuara mbi gjendjen financiare të aplikantit, të cilat justifikojnë nevojën për përfitimin e kësaj ndihme. Ndryshe nga procedurat e tjera gjyqësore, në procedurën e kërkesës për vendim paraprak nuk zbatohet një test mbi perspektivën e suksesit të çështjes ("merits test"), pasi nuk ekziston koncepti i palës fituese ose humbëse. Nëse pala ka përfituar tashmë ndihmë juridike falas në procedurën kombëtare, vendimi përkatës duhet t'i bashkëngjitet kërkesës, pasi ai do të ketë vlerë bindëse.

2.3.3.12 Kur mund të paraqesë një palë vërejtje?

Procedura me shkrim fillon nga momenti kur Sekretaria e Gjykatës njofton zyrtarisht regjistrimin e çështjes. Nga kjo datë palët në procedurën kombëtare, Komisioni Evropian dhe institucioni ose institucionet e Bashkimit Evropian që kanë miratuar aktin juridik objekt interpretimi, kanë një afat prej dy muajsh për të paraqitur vërejtjet e tyre me shkrim pranë Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

2.3.3.13 Si komunikohet me Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian?

I gjithë komunikimi para zhvillimit të seancës dëgjimore realizohet ndërmjet palëve dhe Sekretarisë së Gjykatës së Drejtësisë.

- GJDBE-ja mbështetet në masë të madhe në parashtrësat me shkrim, pasi ato mund të përkthehen me kujdes dhe të analizohen në mënyrë të detajuar. Për këtë arsye, procedura me shkrim ka një rëndësi të veçantë: deri në momentin kur çështja arrin në seancë dëgjimore, gjyqtarët dhe Avokati i Përgjithshëm zakonisht kanë krijuar tashmë një ide paraprake mbi zgjidhjen e mundshme të çështjes.
- Çdo çështje e regjistruar në GJDBE i caktohet një Gjyqtari Relator (Judge-Rapporteur), i cili është gjyqtari përgjegjës për përgatitjen e projektvendimit të Gjykatës. Pas përfundimit të fazës me shkrim, Gjyqtari Relator përgatit një raport paraprak, i cili përmban rekomandime lidhur me përbërjen gjyqësore që do të shqyrtojë çështjen, nevojën ose jo për zhvillimin e një seance dëgjimore dhe nevojën ose jo për paraqitjen e një Opinioni nga Avokati i Përgjithshëm. Edhe Avokati i Përgjithshëm jep mendimin e tij mbi këto çështje. Më pas, Gjykata vendos në mbledhjen e saj të përgjithshme javore, ku marrin pjesë të 27 gjyqtarët, nëse do të ndjekë rekomandimet e paraqitura. Pas mbylljes së procedurës me shkrim, Gjyqtari Relator mund t'u kërkojë palëve të paraqesin informacion shtesë ose dokumente plotësuese. Ai ose ajo mund gjithashtu t'u dërgojë palëve pyetje specifike për t'u trajtuar gjatë seancës dëgjimore. Kjo tregon edhe një herë rëndësinë e procedurës me shkrim në sistemin e Gjykatës së Drejtësisë, pasi shqyrtimi i çështjeve mbështetet kryesisht në vërejtjet dhe argumentet e paraqitura në këtë fazë.

2.3.3.14 Cila dhomë gjyqësore e shqyrton çështjen?

Gjykata zhvillon gjykimin në trupa gjykues prej tre ose pesë gjyqtarësh, dhe ndonjëherë si Dhomë e Madhe prej 15 gjyqtarësh, ndërsa në çështje me rëndësi të jashtëzakonshme ose gjatë ushtrimit të detyrave të veçanta institucionale (siç është vendimmarrja për dorëheqjen e disa zyrtarëve të BE-së), ajo gjykon në përbërje të plotë prej 27 gjyqtarësh. Çështjet u caktohen zakonisht dhomave me tre ose pesë gjyqtarë, përveç rasteve kur rëndësia ose kompleksiteti i tyre justifikon shqyrtimin nga Dhoma e Madhe.

2.3.3.15 A zhvillohet gjithmonë një seancë dëgjimore?

Jo. Nuk ekziston një e drejtë automatike për zhvillimin e një seance dëgjimore. Gjykata mund të vendosë që çështja të shqyrtohet vetëm mbi bazën e parashtresave me shkrim. Në raste të tilla, parashtresat me shkrim mund të përbëjnë mundësinë e vetme për të ndikuar në rezultatin e çështjes. Në përgjithësi, parashtresat me shkrim kanë ndikim më të madh në Gjykatë sesa argumentet e paraqitura gojarisht.

2.3.3.16 Çfarë ndodh pas seancës dëgjimore?

Pas përfundimit të seancës dëgjimore, procedura gojore mbetet e hapur deri në momentin kur Avokati i Përgjithshëm paraqet opinionin e tij ose të saj mbi çështjen. Opinioni përbëhet nga një analizë e arsyetuar juridike, e paraqitur në formë të shkruar. Në ditën e publikimit të opinionit, në seancë lexohet një përmbledhje e shkurtër e tij. Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm përkthehet gjithmonë në gjuhën e çështjes.

2.3.3.17 Opinionet e Avokatëve të Përgjithshëm

- Jo çdo çështje i caktohet një Avokati të Përgjithshëm.
- Paraqitja e argumenteve të bazuara në të drejtat themelore mund të çojë në caktimin e një Avokati të Përgjithshëm për çështjen.
- Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm është një dokument këshillimor jo detyrues, nëpërmjet të cilit rekomandohet mënyra se si Gjykata mund të vendosë për çështjen.
- Avokati i Përgjithshëm është anëtar i Gjykatës, ashtu si edhe gjyqtarët, por nuk merr pjesë në procesin e vendimmarrjes dhe të deliberimit. Roli i tij është të ndihmojë Gjykatën në mënyrë plotësisht të pavarur dhe të paanshme.
- Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm përmban zakonisht një analizë më të gjerë dhe më të detajuar të së drejtës, duke iu referuar shpesh edhe debatit akademik dhe doktrinar mbi çështjen. Ai përfaqëson gjithashtu një mundësi për paraqitjen e një mendimi kundërshtues në një sistem ku aktualisht nuk lejohen opinionet kundërshtuese të gjyqtarëve.
- Opinioni shërben gjithashtu si një mekanizëm kontrolli cilësor, duke siguruar që dhoma gjyqësore që shqyrton çështjen të marrë në konsideratë një analizë autoritative dhe të pavarur përpara se të japë vendimin e saj.

2.3.3.18 Çfarë ndodh pas Opinionit të Avokatit të Përgjithshëm?

- Pas paraqitjes së Opinionit nga Avokati i Përgjithshëm, faza gojore e procedurës përfundon dhe dhoma gjyqësore fillon procesin e deliberimit, në përfundim të të cilit jepet vendimi i Gjykatës.
- Vendimi i Gjykatës zakonisht nuk përmban një arsyetim aq të detajuar sa Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm. Kjo ndodh pjesërisht sepse vendimi përfaqëson qëndrimin kolegjial të të gjithë gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

2.3.4 Faza 3 e procedurës: Kthimi i çështjes në gjykatën kombëtare

- Është e rëndësishme të theksohet se vendimi i GJDBE-së jep vetëm interpretimin e dispozitave përkatëse të së drejtës së BE.
- Pas dhënies së këtij interpretimi, mbetet detyrë e gjykatës kombëtare të zbatojë interpretimin e dhënë nga GJDBE-ja mbi faktet konkrete të çështjes dhe të vendosë mbi themelin e mosmarrëveshjes.
- Në disa raste, veçanërisht kur çështja kërkon një vlerësim proporcionaliteti, interpretimi i dhënë nga GJDBE-ja mund të lërë ende hapësirë për argumente të mëtijshme nga palët në procedurën kombëtare.

2.3.4.1 A janë detyruese vendimet e GJDBE-së për gjykatat kombëtare?

- Vendimet paraprake janë detyruese për gjykatën kombëtare që ka paraqitur kërkesën për vendim paraprak (Çështja C-29/68, *Milchkontor*). Pas marrjes së vendimit të GJDBE-së, gjykata kombëtare duhet të japë vendimin e saj në procedurën kombëtare duke marrë në konsideratë interpretimin e dhënë nga Gjykata.
- Të gjitha organet gjyqësore të BE-së janë gjithashtu të detyruara të ndjekin interpretimin e dhënë nga GJDBE-ja. Kjo rrjedh natyrshëm nga fakti se Gjykata e Drejtësisë është autoriteti më i lartë për interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian dhe se shtetet anëtare janë të detyruara, në bazë të parimit të bashkëpunimit besnik (*principle of sincere cooperation*), të parashikuar në nenin 4(3) të Traktatit për Bashkimin Evropian, të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të së drejtës së Bashkimit. Për më tepër, procedura e parashikuar në nenin 267 TFBE nuk do të arrinte qëllimin e saj themelor – garantimin e interpretimit dhe zbatimit të njëtrajtshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian – nëse autoritetet kombëtare nuk do të ishin të detyruara të ndiqnin interpretimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë.
- Në këtë kontekst, çështja C-453/00, *Kühne & Heitz*, është relevante. Në këtë çështje, GJDBE-ja vlerësoi se, në rrethana të caktuara, organet administrative janë të detyruara, mbi bazën e parimit të bashkëpunimit të sinqertë “parimi i lojalitetit ndaj Bashkimit”, të rishqyrtojnë një vendim që është bërë përfundimtar, kur vendimi fillestar është vënë në dyshim nga një vendim i mëvonshëm i GJDBE-së.
- Ky vendim tregon gjithashtu se vendimet paraprake të GJDBE-së kanë jo vetëm efekt detyrues, por edhe efekt prapaveprues (*ex tunc*). Kjo do të thotë se interpretimi i dhënë nga Gjykata konsiderohet i vlefshëm që nga momenti i hyrjes në fuqi të dispozitës së interpretuar dhe jo vetëm nga data e vendimit.
- Duke qenë se ky efekt prapaveprues mund të sjellë pasoja të rëndësishme financiare dhe mund të cenojë sigurinë juridike, Gjykata e Drejtësisë, në disa raste të veçanta, ka kufizuar efektet kohore të vendimeve të saj. Shembuj të tillë gjenden në Çështjen C-43/75, *Defrenne II*; Çështjen C-24/86, *Blaizot*; Çështjen C-262/88, *Barber*.
- Rekomandohet që vendimet përfundimtare të gjykatave kombëtare të dërgohen pranë Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Aktualisht, këto vendime publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës dhe mund të përdoren prej saj për qëllime kërkimore.

3. Moduli 3: Hartimi dhe paraqitja e kërkesës për vendim paraprak

Objektivat e të nxënës

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të identifikojnë kërkesat formale për paraqitjen e një kërkesë për vendim paraprak;
- të hartojnë pyetje paraprake të qarta dhe të strukturuar;
- të kuptojnë hapat praktikë për paraqitjen e një kërkesë GJDBE-së;
- të identifikojnë elementet thelbësore që duhet të përmbajë një kërkesë për vendim paraprak sipas nenit 94 të Rregullores së Procedurës së GJDBE-së.

3.1 Kërkesa për vendim paraprak

3.1.1 Këshilla praktike

- Kërkesa për vendim paraprak mund të paraqitet në çdo formë të lejuar nga e drejta kombëtare për çështjet procedurale.
- Kërkesa duhet të hartohet në mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe të saktë.
- Kërkesa nuk duhet të jetë më e gjatë se 20 faqe.
- Dokumenti duhet të përgatitet në format të shtypur, në letër të bardhë A4, pa vija. Faqet dhe paragrafët duhet të numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme. Rekomandohet përdorimi i një fonti standard (si p.sh. Times New Roman): madhësia 12 për tekstin kryesor; madhësia 10 për fusnotat; hapësirë ndërmjet rreshtave 1.5; margjina horizontale dhe vertikale jo më të vogla se 2.5 cm.
- Kërkesa për vendim paraprak duhet të jetë e datuar dhe e nënshkruar, dhe më pas të dërgohet me postë të regjistruar në adresën e Sekretarisë së Gjykatës: L-2925, Luxembourg, LUXEMBOURG.
- Kur kërkohet zbatimi i Procedurës Paraprake Urgjente (PPU) ose i Procedurës së Përsheptuar (PPA), një kopje e nënshkruar e kërkesës duhet fillimisht të dërgohet me email në adresën Registry@curia.europa.eu dhe më pas origjinali të dërgohet me postë të regjistruar në adresën e mësipërme. Kërkesa duhet të shoqërohet me çdo dokument relevant dhe të përmbajë të dhënat e sakta të kontaktit të palëve në procedurën kryesore dhe të përfaqësuesve të tyre. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe dosja e çështjes.
- Kërkesa mund të hartohet në gjuhën e procedurës kombëtare. Ajo do të përkthehet në gjuhën frënge, e cila është gjuha e punës së Gjykatës së Drejtësisë, nga shërbimet përkatëse të përkthimit të Gjykatës.

Lista e kontrollit për një kërkesë për vendim paraprak

- ✓ Është identifikuar dispozita relevante e së drejtës së BE-së;
- ✓ Faktet e çështjes janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur;
- ✓ Janë përfshirë dispozitat përkatëse të së drejtës kombëtare;
- ✓ Pyetjet paraprake janë formuluar qartë dhe saktë;
- ✓ Është shpjeguar nevoja për interpretimin e së drejtës së BE-së;
- ✓ Kërkesa është e strukturuar mirë dhe e hartuar në mënyrë koncize.

3.2 Si duhet të hartohet një kërkesë për vendim paraprak?

- Kërkesa mund të paraqitet në çdo formë të lejuar nga legjislacioni kombëtar për çështjet procedurale. Duke qenë se kërkesa do të përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së është thelbësore që ajo të hartohet në mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe të saktë. Rekomandimet tregojnë se një kërkesë me rreth 20 faqe është zakonisht e mjaftueshme.
- Faqet dhe paragrafët duhet të numërtohen.

3.3 Cilat formalitete duhet të respektohen?

Kërkesa duhet të jetë e datuar dhe e nënshkruar, dhe më pas të dërgohet me postë të rekomanduar pranë Sekretarisë së GJDBE-së: L-2925, Luxembourg, LUXEMBOURG.

3.4 Përmbajtja e kërkesës për vendim paraprak

GJDBE-ja është e lidhur me pyetjen/pyetjet e formuluar nga gjykata ose tribunali referues: ajo nuk mund të marrë nismën për t'iu përgjigjur një pyetjeje të së drejtës së BE-së që nuk i është drejtuar. Si avokat në procedurën kryesore, ju mund të ndihmoni që GJDBE-së t'i paraqitet një kërkesë e përshtatshme për vendim paraprak, duke sugjeruar se çfarë duhet të përmbajë urdhri i gjykatës referuese. Shpesh është praktikë e gjykatave që të ftojnë përfaqësuesit ligjorë të bien dakord mbi përmbajtjen e kërkesës për vendim paraprak, e cila më pas miratohet dhe i dërgohet GJDBE-së. Neni 94 i Rregullores së Procedurës parashikon se një kërkesë për vendim paraprak duhet të përmbajë sa vijon:

- Përmbledhjen e objektit të mosmarrëveshjes dhe të konstatimeve faktike të gjykatës referuese. Kjo është e rëndësishme për t'i mundësuar GJDBE-së të kuptojë se si lind çështja e së drejtës së BE-së në rastin konkret. Pa këtë kontekst, do të jetë e vështirë për GJDBE-në të japë një përgjigje të dobishme dhe kërkesa mund të refuzohet.
- Përmbajtjen e dispozitave të së drejtës kombëtare të zbatueshme në rastin konkret. Kur është e përshtatshme, kjo duhet të përfshijë edhe referenca në praktikën gjyqësore që shpjegon se si interpretohen këto dispozita.
- Arsytet që e shtynë gjykatën kombëtare të kërkojë interpretimin e dispozitave të së drejtës së BE-së, si dhe marrëdhënien ndërmjet këtyre dispozitave dhe legjislacionit kombëtar të zbatueshëm. Në thelb, duhet të shpjegohet se si lind në rastin konkret pyetja që po referohet. Përveç elementeve të parashikuara në nenin 94 të Rregullores së Procedurës, kërkesa duhet të përfshijë edhe:
- Vetë pyetjet, të cilat duhet të kërkojnë drejtpërdrejt interpretimin e dispozitave të së drejtës së BE-së. Është e mundur të parashtrohen edhe pyetje pasuese, domethënë: nëse përgjigjja për pyetjen e mëparshme është X, atëherë...
- Nëse është e përshtatshme, një kërkesë të veçantë për zbatimin e procedurës urgjente ("PPU") — për këtë, shihni Pjesën IV të këtij udhëzuesi mbi PPU-në. Këshillë praktike nga një gjyqtar i një gjykate kombëtare: Merrni në konsideratë përfshirjen e një pyetjeje plotësuese në kërkesën për vendim paraprak, për t'u trajtuar nga GJDBE-ja në rast se ajo i përgjigjet negativisht pyetjes së parë.
- Struktura e kërkesës. Përmbajtja e kërkesës përcaktohet nga neni 94 i Rregullores së Procedurës së GJDBE-së dhe përmbledhet në Aneksin e Rekomandimeve. Ju lutemi vini re se, në mungesë të ndonjë prej informacioneve të kërkuara, GJDBE-ja mund të refuzojë juridiksionin ose ta rrëzojë kërkesën si të papranueshme.

Kërkesa duhet të përmbajë shtatë seksionet e mëposhtme:

1. Gjykata ose tribunali referues. Lutemi, të specifikohet emri i plotë i gjykatës ose tribunalit referues, si dhe të dhënat e plota të kontaktit.
2. Palët në procedurën kryesore dhe përfaqësuesit e tyre. Tregoni emrat e palëve në procedurën kryesore dhe të çdo personi që i përfaqëson ato përpara asaj gjykate ose tribunali. Ju lutemi të përfshini adresën e saktë postare të personave përkatës, numrin e tyre të telefonit ose të faksit, si dhe adresën e email-it.
3. Objekti i mosmarrëveshjes në procedurën kryesore dhe faktet përkatëse. Ju lutemi të përshkruani shkurtimisht objektin e mosmarrëveshjes në procedurën kryesore dhe konstatimet përkatëse faktike, siç janë përcaktuar nga gjykata ose tribunali kompetent kombëtar.
4. Dispozitat ligjore përkatëse. Ju lutemi të përfshini referenca të sakta për dispozitat kombëtare të zbatueshme ndaj fakteve të mosmarrëveshjes në procedurën kryesore, duke përfshirë çdo praktikë gjyqësore përkatëse. Referencat duhet të përfshijnë titullin e saktë dhe citimet për dispozitat përkatëse, si dhe referencat e botimit të tyre. Në këtë seksion, ju lutemi të identifikoni gjithashtu dispozitat e së drejtës së BE-së, interpretimi i të cilave kërkohet.
5. Arsyet e referimit. Ju lutemi të parashtroji arsyet që kanë nxitur paraqitjen e kërkesës dhe të specifikoni marrëdhënien ndërmjet dispozitave të së drejtës së BE-së dhe legjislacionit kombëtar të zbatueshëm në procedurën kryesore.
6. Pyetjet e referuara për vendim paraprak. Pyetja/pyetjet e referuara në GJDBE duhet të jenë të pavarura dhe të kuptueshme në vetvete. Ju lutemi të parashtroji gjithashtu edhe një qëndrim mbi përgjigjen që duhet t'i jepet pyetjes/pyetjeve.
7. Nevoja e mundshme për trajtim të posaçëm. Ju lutemi të tregoni nëse personi/personat përkatës duhet të mbeten anonimë, ose nëse kërkesa duhet të trajtohet me urgjencë.

4. Moduli 4: Procedurat urgjente dhe masat e përkohshme

Objektivat e të nxënës

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë masat e përkohshme që mund të kërkohen para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) dhe Gjykatës së Përgjithshme;
- të dallojnë ndërmjet Procedurës Paraprake Urgjente (PPU) dhe Procedurës së Përsheptuar (PPA);
- të identifikojnë situatat në të cilat mund të zbatohen procedurat urgjente;
- të kuptojnë reformat e fundit që lidhen me procedurat e referimit paraprak para Gjykatës së Përgjithshme.

4.1 Masat e përkohshme në Gjykatën e Përgjithshme dhe në GJDBE

Sipas neneve 278 dhe 279 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), paraqitja e një padie para Gjykatës së Drejtësisë nuk ka efekt pezullues ndaj aktit të kundërshtuar. Megjithatë, Gjykata mund të urdhërojë, nëse vlerëson se rrethanat e kërkojnë, pezullimin e zbatimit të aktit të kundërshtuar ose marrjen e masave të tjera të nevojshme.

- **Ekzistojnë dy kategori kryesore masash** që mund të urdhërohen, sipas neneve 278 dhe 279 TFBE:
 - 1-një masë të posaçme të përkohshme, konkretisht pezullimin e zbatimit ose ekzekutimit të aktit të kundërshtuar; dhe
 - 2-masa të tjera, të cilat nuk janë të specifikuara më tej, por që Gjykata i çmon të nevojshme, për shembull, lidhur me procedurat që duhet të ndiqen, përfshirë çështjen nëse qeverisë duhet t'i jepet mundësia të paraqesë komente ose t'u përgjigjet kërkesave për masa parandaluese përpara se ato të vendosen.
- Masat e përkohshme mund të kërkohen në paditë e drejtpërdrejta.
- **Mbrojtja Juridike e Përkohshme përpara Gjykatave Kombëtare:** Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë mundësinë e mbrojtjes gjyqësore të menjëhershme dhe të përkohshme kur kjo është e nevojshme për ta bërë efektive mbrojtjen juridike.
- Vendimi i GJDBE-së në çështjen Factortame, C-213/89, ECLI:EU:C:1990:257: mbështetet në parimin e bashkëpunimit të singertë, neni 4(3) TBE, dhe në parimin e efektivitetit.
- Vendimi i GJDBE-së në çështjen C-432/05, Unibet, ECLI:EU:C:2007:163: baza u zhvendos te parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore. Ky parim kërkon që “në rendin juridik të një Shteti Anëtar të jetë e mundur dhënia e masave të përkohshme, derisa gjykata kompetente të ketë dhënë vendim mbi përputhshmërinë e dispozitave kombëtare me të drejtën e Bashkimit, kur dhënia e këtyre masave të përkohshme është e nevojshme për të siguruar efektivitetin e plotë të vendimit që do të jepet mbi ekzistencën e të drejtave që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit në procedurën kryesore.”

4.2 Procedurat urgjente: PPU dhe PPA

4.2.1 Karakteristikat kryesore të Procedurës Paraprake Urgjente (PPU)

- Gjykata kombëtare referuese mund të kërkojë zbatimin e Procedurës Paraprake Urgjente (PPU).
- Gjykata e Drejtësisë cakton një dhomë prej pesë gjyqtarësh, e cila funksionon mbi bazën e rotacionit dhe është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave PPU. Kjo dhomë vendos nëse kërkesa për trajtim urgjent duhet të pranohet ose jo.
- Procedura PPU pranohet zakonisht kur një person ndodhet në paraburgim në pritje të përfundimit të procedurës.
- Nëse kërkesa për PPU pranohet, kërkesa për vendim paraprak i njoftohet vetëm Shtetit Anëtar përkatës (dhe jo të gjitha Shteteve Anëtare), si dhe institucionit të BE-së që ka miratuar legjislacionin në fjalë.
- Vendimi për trajtimin e kërkesës sipas procedurës urgjente përcakton afate më të shkurtra për paraqitjen e vërejtjeve nga këto palë dhe mund të përcaktojë çështjet që duhet të trajtohen në vërejtje, si dhe gjatësinë maksimale të tyre, duke kursyer kështu kohën e përkthimit.
- Vendimi u dërgohet gjithashtu palëve të tjera të interesuara (domethënë, Shteteve Anëtare), të cilat informohen për datën e mundshme të seancës, në mënyrë që të mund të paraqesin vërejtje me atë rast (pra, jo me shkrim, sërish, për të kursyer kohën e përkthimit).
- Dhoma duhet të 'dëgjojë' Avokatin e Përgjithshëm. Praktika aktuale është që Avokati i Përgjithshëm të nxjerrë një 'qëndrim', i cili publikohet dhe u njoftohet palëve në të njëjtën kohë me Vendimin.

4.2.1.1 Çfarë është procedura urgjente?

Kohëzgjatja mesatare e një procedure për vendim paraprak është rreth 18 muaj. Për një person që ndodhet në paraburgim ose në arrest, kjo periudhë mund të jetë tepër e gjatë. Për këtë arsye, që prej vitit 2008, Gjykata e Drejtësisë ka vendosur një procedurë të posaçme urgjente për kërkesat për vendim paraprak, të njohur si PPU (*procédure préjudicielle d'urgence*). Për praktikuesit e së drejtës penale, kjo procedurë ka rëndësi të veçantë dhe përdoret shpesh në praktikë. Në kuadër të PPU-së, Gjykata e Drejtësisë zakonisht vendos brenda pak muajsh nga data e paraqitjes së kërkesës nga gjykata kombëtare. Procedura PPU rregullohet nga nenet 107–114 të Rregullores së Procedurës së Gjykatës dhe karakterizohet nga një proces më i thjeshtuar. Në veçanti, mund të kufizohet numri i palëve që lejohen të paraqesin vërejtje me shkrim, gjatësia e parashtrësve, afatet për paraqitjen e tyre dhe procedura me shkrim zhvillohet kryesisht në mënyrë elektronike. Në raste jashtëzakonisht urgjente, procedura me shkrim mund të hiqet tërësisht, megjithëse kjo ndodh rrallë në praktikë.

4.2.1.2 Kush mund të kërkojë procedurën urgjente?

Në parim, kërkesa për zbatimin e procedurës PPU paraqitet nga gjykata referuese. Gjykata duhet të shpjegojë në mënyrë të detajuar elementet faktike dhe juridike që justifikojnë urgjencën e çështjes dhe nevojën për përdorimin e kësaj procedure të jashtëzakonshme.

4.2.1.3 Kur mund të përdoret procedura urgjente?

- Procedura urgjente zbatohet vetëm në fushën e **Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (Area of Freedom, Security and Justice – AFSJ)**, duke përfshirë legjislacionin e BE-së që lidhet me azilin, emigracionin, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale. PPU përdoret vetëm në raste urgjente kur është e nevojshme që Gjykata e Drejtësisë të vendosë në një afat shumë të shkurtër.
- Nuk ekziston një listë shteruese kriteresh që përcakton kur duhet të zbatohet kjo procedurë.

Megjithatë, janë identifikuar **tre situata** tipike:

- 1-Kur një person ndodhet në arrest, paraburgim ose është privuar në një mënyrë tjetër nga liria dhe përgjigja e Gjykatës është vendimtare për vlerësimin e situatës së tij juridike.
- 2-Kur ekziston rreziku i shkakimit të një dëmi serioz dhe potencialisht të pariparueshëm ndaj marrëdhënies ndërmjet prindit dhe fëmijës ose i një dëmi tjetër të rëndë psikologjik. Kjo situatë mund të paraqitet, për shembull, në procedurat që lidhen me përgjegjësinë prindërore, kujdestarinë e fëmijëve, kthimin e një fëmije të privuar nga kontakti me njërin prej prindërve.
- 3- Kur ekziston një rrezik real që të cenohen të drejtat themelore të personave të përfshirë, siç është mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor ose degradues.

Procedura urgjente mbështetet në nenin 23a të Statutit të GJDBE-së ndërsa rregullat e hollësishme procedurale parashikohen në nenet 107–114 të Rregullores së Procedurës së Gjykatës.

4.2.1.4 Cili është ndikimi praktik i procedurës urgjente?

- Në praktikë, procesi PPU mund të zhvillohet shumë shpejt nga momenti kur ngrihet një çështje e së drejtës së BE-së. Kjo procedurë përdoret kryesisht në çështje që lidhen me përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e fëmijëve të mitur, ose në çështje kur një person ndodhet në paraburgim.
- Gjykata e Drejtësisë cakton Dhoma të posaçme prej pesë Gjyqtarësh për të trajtuar këto çështje. Të gjitha afatet reduktohen ndjeshëm. Aksesit në procedurën me shkrim është i kufizuar, ku shumica e palëve marrin pjesë vetëm në seancë.

4.2.2 Karakteristikat kryesore të Procedurës së Përsheptuar (PPA)

- Fusha e zbatimit të PPA-së është më e gjerë se ajo e PPU-së, e cila është e kufizuar në fushën AFSJ. Përdoret për çështje që nuk mbulohen nga PPU-ja, por që kërkojnë trajtim të përsheptuar.
- E disponueshme si për Gjykatën e Drejtësisë, ashtu edhe për Gjykatën e Përgjithshme.
- Hapat e procedurës së zakonshme për vendim paraprak: brenda 1 viti jepet vendimi nga GJDBE-ja. Çështjes i jepet përparësi absolute dhe fazat me shkrim shkurohen ndjeshëm.
- Arsyet për PPA: rrezik për shëndetin publik, sistemin financiar të BE-së, të drejta themelore urgjente në rrezik, si dëbimi i të huajve (të drejta themelore: parimi i moskthimit ose jeta familjare), çështje kushtetuese të së drejtës së BE-së (shih vendimin e GJDBE-së në çështjet e bashkuara C-758/24 (Al-ace) dhe C-759/24 (Canpelli)), ndalimi/mbajtja në kujdestari e një personi.
- Nuk përbëjnë arsye për PPA: numri i madh i çështjeve në pritje përpara gjykatës kombëtare, arsyet ekonomike.

PPU (Procedura Paraprake Urgjente)	PPA (Procedura e Përsheptuar)
Kufizohet vetëm në çështjet e fushës së Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (AFSJ)	Ka fushë zbatimi më të gjerë
Kërkon urgjencë të jashtëzakonshme	Kërkon trajtim të përsheptuar
Përdoret shpesh në rastet e paraburgimit ose çështjeve që lidhen me fëmijët	Përdoret për çështje të tjera urgjente të së drejtës së BE-së
Afate jashtëzakonisht të shkurtra	Afate të reduktuara krahasuar me procedurën e zakonshme
Zakonisht përfundon brenda pak muajsh	Më e shpejtë se procedura standarde, por zakonisht më e gjatë se PPU

4.3 Ndryshimet lidhur me kërkesat për vendim paraprak para Gjykatës së Përgjithshme

- Më 1 shtator 2024, hyri në fuqi një ndryshim i rëndësishëm i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian ("Statuti"). Ky ndryshim do t'i japë fund juridiksionit aktual ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në procedurat e kërkesave për vendim paraprak. Nga 1 tetori 2024 e në vijim, juridiksioni do të transferohet nga GJDBE-ja te Gjykata e Përgjithshme e Bashkimit Evropian në gjashtë fusha specifike.
- Për më tepër, ndryshimi prezanton ndryshime procedurale që rrisin transparencën në procedurat e kërkesave për vendim paraprak dhe zgjeron mekanizmin aktual për përjashtimin e ankimeve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme.
- Ndryshimi i Statutit i jep juridiksion Gjykatës së Përgjithshme në gjashtë **fusha specifike**, të cilat përfaqësojnë afërsisht 20% të të gjitha procedurave të kërkesave për vendim paraprak dhe për të cilat është krijuar një praktikë e konsiderueshme gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë.
- GJDBE-ja ruan juridiksionin mbi çështjet që lidhen edhe me fusha të tjera ose që, në çdo rast, ngrenë pyetje të pavarura të një natyre themelore. Konkretisht, juridiksioni transferohet nga Gjykata e Drejtësisë te Gjykata e Përgjithshme në çështjet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me pyetje të së drejtës së BE-së brenda njërës prej fushave të mëposhtme:
 - sistemi i përbashkët i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);
 - akcizat;
 - Kodi Doganor i Bashkimit Evropian;
 - klasifikimi tarifar i mallrave sipas Nomenklaturës së Kombinuar;
 - kompensimi dhe asistenca për pasagjerët në rast refuzimi të hipjes, vonesash ose anulimi të shërbimeve të transportit;
 - sistemi i tregtimit të kuotave të emetimeve të gazeve serrë.
- Ky ndryshim është pjesë e një reforme më të gjerë të sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian, e cila synon rritjen e efikasitetit të gjyqimit. Reforma mbështetet edhe në **ndryshimet e mëparshme institucionale**, të cilat rritën numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Përgjithshme.

- Ndryshimi bazohet në tre shtylla kryesore: (i) transferimi i kompetencës nga GJDBE tek Gjykata e Përgjithshme për kategori të caktuara të kërkesave për vendim paraprak; (ii) ndryshime procedurale në procedurat e referimit paraprak; (iii) zgjerimi i mekanizmit që kufizon ankimin ndaj disa vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme. Duke pasur parasysh se dy funksionet kryesore të Gjykatës së Drejtësisë janë: dhënia e vendimeve paraprake; dhe shqyrtimi i ankimeve për çështje ligjore kundër vendimeve dhe urdhrave të Gjykatës së Përgjithshme, kjo reformë përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në arkitekturën gjyqësore të BE-së.

4.3.1 Vendimet paraprake

- Vendimet paraprake janë vendime të dhëna në kuadër të procedurës së referimit paraprak të iniciuar nga një gjykatë e një shteti anëtar të BE-së. Kjo procedurë mund të iniciohet nga gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe duhet të iniciohet nga gjykatat e shkallës së fundit kur lindin paqartësi lidhur me interpretimin ose vlefshmërinë e së drejtës së BE-së. Procedura e referimit paraprak përbën një nga gurët themelorë të sistemit gjyqësor të BE-së, pasi garanton interpretimin dhe zbatimin e njëtrajtshëm të së drejtës së Bashkimit në të gjitha shtetet anëtare.

4.3.2 Transferimi i kompetencës nga GJDBE tek Gjykata e Përgjithshme

- Mundësia për t'i dhënë juridiksion Gjykatës së Përgjithshme për procedurat e kërkesave për vendim paraprak në disa lloje çështjesh ka ekzistuar prej **më shumë se dy dekadash**. Ajo përdoret tani si përgjigje ndaj rritjes së numrit të procedurave të kërkesave për vendim paraprak në pritje dhe kohës mesatare që nevojitet për trajtimin e tyre. Për të siguruar që Gjykata e Drejtësisë të mund të vazhdojë të garantojë unitetin dhe koherencën e së drejtës së BE-së dhe të japë vendime të cilësisë së lartë, transferimi i juridiksionit të Gjykata e Përgjithshme në fusha specifike u konsiderua i nevojshëm.
- Ndryshimi i Statutit i jep juridiksion Gjykatës së Përgjithshme **në gjashtë fusha specifike**, të cilat përfaqësojnë afërsisht 20% të të gjitha procedurave të kërkesave për vendim paraprak dhe për të cilat është krijuar një praktikë e konsiderueshme gjyqësore e GJDBE-së. GJDBE-ja ruan juridiksionin mbi çështjet që lidhen edhe me fusha të tjera ose që, në çdo rast, ngrenë pyetje të pavarura të një natyre themelore.
- GJDBE-ja vendos fillimisht për shpërndarjen e çështjeve ndërmjet GJDBE-së dhe Gjykatës së Përgjithshme. Prandaj, gjykatat kombëtare mund të vazhdojnë t'i referojnë pyetjet e tyre paraprake në GJDBE. Gjykata e Përgjithshme mund të rivlerësojë vendimin e GJDBE-së për shpërndarjen dhe mund të përmbahet nga marrja e juridiksionit mbi çështje që kërkojnë një vendim parimor, i cili mund të ndikojë në unitetin ose koherencën e së drejtës së BE-së.
- Për të garantuar sigurinë juridike dhe transparencën lidhur me shpërndarjen e çështjeve, vendimet e ardhshme të GJDBE-së dhe të Gjykatës së Përgjithshme duhet të japin arsytet se përse gjykata përkatëse është kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur mbi një pyetje paraprake.
- Për të garantuar garanci të barasvlershme në të gjitha procedurat e kërkesave për vendim paraprak, ndryshimi sjell detyrimin për të përafuar rregullat procedurale të Gjykatës së Përgjithshme me ato të GJDBE-së. Në këtë drejtim, gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme **duhet të** zgjedhin ndërmjet tyre gjyqtarët që do të ushtrojnë detyrat e Avokatit të Përgjithshëm për një periudhë trevjeçare të rinovueshme.

4.3.3 Ndryshimet procedurale në procedurat e referimit paraprak

Përveç transferimit të kompetencës nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) tek Gjykata e Përgjithshme në fusha të caktuara, ndryshimet në Statut sjellin edhe disa risi procedurale që zbatohen për të gjitha procedurat e referimit paraprak.

- Së pari, të gjitha kërkesat për vendim paraprak tani duhet t'i **njoftohen** Parlamentit Evropian, Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane, të cilat më pas mund të vendosin nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të paraqitur parashtresa ose vërejtje me shkrim. Së dyti, publikimi i këtyre parashtresave ose vërejtjeve të të gjitha palëve të përfshira (brenda një periudhe të arsyeshme pas përfundimit të çështjes) tani do të jetë rregull, ndryshe nga praktika aktuale e publikimit individual me kërkesë. Në këtë drejtim, një palë mund të kundërshtojë vetëm publikimin e parashtresës/vërejtjes së saj.

4.3.4 Ankimet për çështje ligjore kundër vendimeve dhe urdhrave të Gjykatës së Përgjithshme

- Shqyrtimi i ankimeve për çështje ligjore kundër vendimeve dhe urdhrave të Gjykatës së Përgjithshme përbën një nga funksionet kryesore të GJDBE-së.
- Neni 256 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon se shtrirja e kësaj kompetence mund të përcaktohet nëpërmjet Statutit të Gjykatës. Ndryshimi i fundit zgjeron **mekanizmin** ekzistues që përcakton nëse një ankim mund të shqyrtohet nga Gjykata e Drejtësisë. Në çështjet që mbulohen nga ky mekanizëm, ankimi lejohet vetëm nëse Gjykata e Drejtësisë vlerëson se çështja ngre një problem me rëndësi për unitetin, koherencën ose zhvillimin e së drejtës së BE-së.
- Sipas statistikave të Gjykatës së Drejtësisë, një numër i konsiderueshëm ankimesh paraqiten kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme. Për të ruajtur efikasitetin e procedurave të ankimit dhe për t'i mundësuar Gjykatës së Drejtësisë të përqendrohet në çështje me rëndësi të veçantë juridike, mekanizmi i filtrimit të ankimeve është zgjeruar në dy drejtime.
- Së pari, bordet e pavarura të ankimit brenda organeve, zyrave ose agjencive të BE-së janë shtuar në listën e bordeve përkatëse të ankimit, vendimet e të cilave, në parim, bien nën juridiksionin e Gjykatës së Përgjithshme si shkallë e parë dhe e fundit. Lista tani përbëhet nga bordet e mëposhtme të ankimit:
 - Zyrën e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale (EUIPO);
 - Zyrën Komunitare për Varietetet Bimore (CPVO);
 - Agjencinë Evropiane të Kimikateve (ECHA);
 - Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Ajrore (EASA);
 - Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER);
 - Bordin e Vetëm të Zgjidhjes (Single Resolution Board);
 - Autoritetin Bankar Evropian (EBA);
 - Autoritetin Evropian të Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA);
 - Autoritetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA);
 - Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat (ERA).
- Së dyti, është shtuar një kategori e re për përjashtim për disa çështje të Gjykatës së Përgjithshme që lidhen me vendime mbi kontrata që përmbajnë një klauzolë arbitrazhi.

- Në parim, Gjykata e Përgjithshme tani ka juridiksion si shkallë e parë dhe e fundit për mosmarrëveshjet që lidhen me zbatimin e kontratave që përmbajnë një klauzolë arbitrazhi – ndërmjet një institucioni, organi ose agjencie të BE-së dhe një pale private – të cilat nuk ngrenë çështje që janë të rëndësishme për unitetin, koherencën ose zhvillimin e së drejtës së BE-së.

4.3.5 Ndikimi i amendimit

Edhe pse amendimi përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në dy funksionet kryesore të GJDBE-së, mbetet për t'u parë se në çfarë mase ai do t'i mundësojë GJDBE-së të menaxhojë punën e saj në mënyrë më efektive, veçanërisht në afat të gjatë.

- Është gjithashtu e pasigurt se cilat efekte të tjera, ndoshta të paparashikuara, mund të sjellë ndryshimi. Për shembull, koha do të tregojë nëse reforma e mëparshme gjyqësore, që rriti numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Përgjithshme, do të ulë kohën mesatare të nevojshme për trajtimin e procedurave të kërkesave për vendim paraprak, veçanërisht pasi barriera për gjykatat kombëtare për t'i drejtuar pyetje paraprake Gjykatës së Përgjithshme mund të jetë më e ulët.

Përmbledhje e pikave kryesore

Procedura e vendimit paraprak është një nga mekanizmat qendrorë për të garantuar zbatimin uniform dhe mbrojtjen efektive gjyqësore të së drejtës së BE-së. Gjykatat kombëtare luajnë një rol kyç në këtë dialog gjyqësor me GJDBE-në.

Dokumentet e aneksit

Statuti i Gjykatës

https://curia.europa.eu/site/upload/docs/application/pdf/2024-08/statut_cour_en.pdf

Rregullorja e Procedurës

<https://curia.europa.eu/site/upload/docs/application/pdf/2024-08/rdp-cour-en.pdf>

Rregullat plotësuese të Gjykatës

<https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2014:032:0037:0045:EN:PDF>

Rekomandime për gjykatat dhe tribunatet kombëtare lidhur me fillimin e procedurave të vendimit para-prak (C/2024/6008)

https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C_202406008

Kushtet e përdorimit të E-Curia

https://curia.europa.eu/site/upload/docs/application/pdf/2024-09/2024-09-05_conditions-utilisation-ecuria_en_2024-09-25_10-50-7_866.pdf

Mbrojtja e të dhënave personale në procedurat pranë Gjykatës

https://curia.europa.eu/site/upload/docs/application/pdf/2015-11/tra-doc-en-div-c-0000-2015-201508723-05_00.pdf

Publikimi i parashtresave dhe vërejtjeve me shkrim të paraqitura në çështjet e vendimeve paraprake

<https://curia.europa.eu/site/upload/docs/application/pdf/2025-04/observations-ecrites-en.pdf>

Rregullorja (BE, Euratom) 2024/2019 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 prill 2024, që ndryshon Protokollin nr. 3 mbi Statutin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian

<https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2024/2019/oj>

Raporti vjetor i GJDBE-së 2025

<https://curia.europa.eu/site/upload/docs/application/pdf/2026-03/qd-01-25-007-en-n.pdf>

- M. Broberg and N. Fenger, Preliminary References to the European Court of Justice (3rd edn, Oxford 2021)
- M. Costa and S. Peers, 'The Preliminary Ruling Procedure', Steiner and Woods EU Law, 15th edn (Oxford, 2023; online edn, Oxford Law Pro, 1 Aug. 2023)
- C. Lacchi, Preliminary References to the Court of Justice of the European Union and Effective Judicial Protection (Larcier, 2020)
- K.J. de Graaf, H.J. van Harten, A. Prechal, R.J.G.M. Widdershoven, Judicial Coherence in the European Union, Europa Law Publishing (2016)
- S. Prechal and A. Pahladsingh, Urgency and Human Rights in EU Law: Procedures Before the Court of Justice of the EU (2020)

